

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës				
Data e aplikimit	<b>23.09.2024</b>			
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	<b>“BRICKOS”sh.p.k, Zgjerim për vëndshfrytëzimin e argjilës për prodhimin e bllokave nga argjila ne lokacionin Topanicë - Kamenicë dhe Kërminjan i Poshtëm-Ranillug</b>			
Vlera financiare investuese e projektit (ne euro)	€	<b>82,000.00</b>		
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor ( në euro)	€	<b>300.00</b>		
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,			Po	Jo
	1. Raporti i VNM-së në katër (4) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-s (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).		Po	
	2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartes zonale, kushtet ndertimore		Po	
	3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit		Po	
	4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).		Po	
	5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref		Po	
	6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar		Po	
	7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuesit për pëlqim mjedisor			Jo
	8. Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor, sipas udhëzimit administrativ Nr.08/2015		Po	
	9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit		Po	

	<p>11. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materje eksplozive: Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejimin e vendosjes së rezervuarëve</p>	Jo	
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	<b>Kamer Borovci</b>		
Kompania	<b>“Brickos”sh.p.k</b>		
Adresa e Kompanisë	Kërminjan i Poshtëm, K.Ranillug dhe Topanicë, K.Kamenicë		
Tel, fax, E-maili	<b>Tel:</b> 044-343-062; <b>Email:</b> <u><a href="mailto:brickos.ks@gmail.com">brickos.ks@gmail.com</a></u>		

**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJËDIS**

**“BRICKOS” sh.p.k, Zgjerim për vëndshfrytëzimin e argjilës për prodhimin e bllokave nga argjila ne lokacionin Topanicë - Kamenicë dhe Kërminjan i Poshtëm-Ranillug**



**Shtator, 2024**

**RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

**“Brickos”sh.p.k, Zgjerim për vëndshfrytëzimin e argjilës për prodhimin e bllokave nga argjila ne lokacionin Topanicë - Kamenicë dhe Kërminjan i Poshtëm-Ranillug**

**Aplikuesi: “Brickos”sh.p.k**  
(Investitor)

Përson përgjegjës:  
Kamer Borovci, Drejtor  
Adresa: Kërminjan i Poshtëm,  
K.Ranillug dhe Topanicë,  
K.Kamenicë, 62000 Kamenicë

**Tel:** 044-343-062

**Email:** [brickos.ks@gmail.com](mailto:brickos.ks@gmail.com)

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

**Datë:** 23.09.2024

**Hartuesi i raportit të VNM-së:**

**Dr. Sc. Pajtim Bytyçi**

**Email:** [pajtim.bytyqi@hotmail.com](mailto:pajtim.bytyqi@hotmail.com)

**Tel:** +383 44 766 442

**Adresa:** Prishtinë

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

**Datë:** 23.09.2024

## Përmbajtja:

1. HYRJE.....	7
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VNM-SË.....	8
Korniza Ligjore Kombëtare e Mjedisit .....	9
Procedura e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.....	15
3. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE EKZISTUESE MJEDISORE .....	16
Pozicioni Gjeografik dhe Topografia.....	16
Kushtet Klimatike .....	19
Kualiteti i Ajrit.....	22
Zhurma .....	23
Gjeologjia.....	23
Hidrologjia.....	24
Kualiteti i Ujërave .....	26
Menaxhimi i Mbetjeve .....	26
Përmytjet.....	28
Rrëshqitjet e dheut dhe Erozioni .....	29
Përdorimi i Tokës .....	31
Biodiversiteti .....	32
Zonat e mbrojtura natyrore .....	33
Mjedisi Social.....	35
Demografia .....	35
Ekonomia.....	35
Trashëgimia Kulturore .....	36
4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....	37
Lokacioni.....	41
5. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT .....	45
Ndikimet në cilësinë e ajrit.....	45
Ndikimet në tokë .....	46
Masat për mbrojtjen e tokës .....	46
Ndikimet në mjedisin ujor.....	47
Masat për mbrojtje nga zhurma .....	47

<b>6. MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....</b>	<b>50</b>
<b>7. KONKLUZIONE .....</b>	<b>51</b>
<b>8. REFERENCAT .....</b>	<b>52</b>

**Shkurtesat:**

<b>AMMK</b>	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>IHMK</b>	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
<b>MMPHI</b>	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>PKP</b>	Plani i Konsultimit Publik
<b>PMM</b>	Plani për Menaxhimin Mjedisor
<b>VNM</b>	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
<b>VSNM</b>	Vlerësimi Strategjik i Ndikimit në Mjedis

## 1. HYRJE

Ndërmarrja "Brickos" sh.p.k, me seli në fshatin Kërminjan i Poshtëm (Komuna e Ranillugut) është ndërmarrje prodhuese e materialeve ndërtimore nga argjila e pjekur. Me qëllim minimizimit të efekteve negative në mjedis dhe të përmbushjes së obligimeve ligjore "Brickos" sh.p.k. ka bërë përgatitjen e dokumentacionit për hartim të Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në përputhje me LIGJI Nr. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS, duke angazhuar ekspert të licencuar nga MMPHI.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis -VNM nënkupton identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme të projektit, konsultimin e autoriteteve mjedisore dhe të publikut, duke marrë parasysh raportin e VNM dhe rezultatet e konsultimeve në vendimmarrje, përcaktimin e metodës për parandalimin, shmangien, zbutjen ose rehabilitimin e ndikimeve të dëmshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe dhënien e informatave mbi vendimin

Si rezultat i këtij vlerësimi të ndikimit në mjedis për operimin e "Brickos" sh.p.k., është hartuar ky raporti i VNM-së, i cili paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, për "Brickos" sh.p.k.

Përmes këtij raporti të VNM-së janë identifikuar, përshkruar dhe vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat e secilit rast individual, efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projekti lidhur me zgjerimin e vendshfrytëzimit të argjilës me lokacion ne Topanicë në:

- njeriun, botën bimore dhe shtazore;
- tokë, ujë, ajër, klimë dhe peizazh;
- të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore;
- ndikimet e ndërsjella të elementeve të cekura më sipër.

Raporti i VNM-së përmban:

- përshkrimin e projektit, përfshirë në veçanti:
  - përshkrimin e karakteristikave fizike të projektit si tërësi dhe kushteve për përdorim të tokës, gjatë fazës së ndërtimit dhe të operimit;
  - përshkrimin e karakteristikave kryesore të procesit;
  - vlerësimin e përafërt, sipas llojit dhe sasisë së mbetjeve dhe emisioneve - ndotja e ujit, ajrit, tokës, zhurma, vibrimi, etj.- që rezultojnë nga projekti i propozuar.
- paraqitja e alternativave kryesore të identifikuara nga ana e aplikuesit dhe dhënia e arsyeve kryesore për zgjidhjen e njëres prej tyre, duke i marrë parasysh efektet mjedisore;

- një përshkrim të aspekteve mjedisore për të cilat ekziston mundësia e ndikimeve të theksuara negative nga projekti i propozuar, përfshirë, para së gjithash, popullatën, botën bimore dhe shtazore, tokën, ujin, ajrin, faktorët klimatik, vlerat materiale duke përfshirë trashëgiminë kulturore, arkitektonike dhe arkeologjike, peizazhin dhe raportet e ndërmjetme në mes të faktorëve të lartshënuar;
- një përshkrim të ndikimeve të mundshme të theksuara të projektit të propozuar në mjedis si: ndikimet e drejtpërdrejta dhe çfarëdo ndikimi i tërthortë, sekondar, kumulativ, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, i përhershëm dhe i përkohshëm, pozitiv dhe negativ, që rezultojnë nga:
  - realizimi i projektit;
  - shfrytëzimi i resurseve natyrore
  - emisionet e ndotësve, krijimi i shqetësimeve tjera dhe eliminimi i mbeturinave
  - përshkrimi nga ana e aplikuesit të metodave parashikuese të përdorura për të vlerësuar ndikimet në mjedis. Këto ndikime duhet të përfshijnë ato që rezultojnë nga ndërtimet ose ekzekutimi i ndonjë projekti si dhe atyre që rezultojnë nga ekzistenca ose operacioni i projektit, pasi ai të jetë përfunduar.
- përshkrimi i masave të parapara për të parandaluar, zvogëluar dhe aty ku është e mundur mënjanimin e çfarëdo ndikimi të theksuar në mjedis;
- Përmbledhjen Jo-Teknike të informatave të përshkruara më lartë;
- shënimi i çfarëdo vështirësie - mangësive teknike ose mungesës së njohurive, në të cilat has aplikuesi gjatë hartimit të informatave të kërkuara.

## 2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E VNM-SË

Kosova ka legjislacion Mjedisor dhe Social që rregullon politikat, procedurat dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe përdorimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore, punën dhe kushtet e punës, dhe angazhimin e palëve të interesuara. Ky kapitull paraqet një përmbledhje të kuadrit rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë politikat, legjislacionin, kërkesat, udhëzimet dhe standardet e zbatueshme për Projektin. Në prani të standardeve të shumta që vijnë nga burime të ndryshme rregullatore, Projekti do të zbatojë standardet më të rrepta për të mbrojtur mjedisin dhe komunitetet që mund të preken nga projekti.



## Korniza Ligjore Kombëtare e Mjedisit

### Mbrojtja e Mjedisit

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (03/L-025) është dokumenti juridik i nivelit më të lartë mjedisor në Kosovë që rregullon parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes, rregullon monitorimin e mjedisit dhe përcakton parimet e përdorimit racional të burimeve natyrore. Sipas këtij ligji, projektet e planifikuara, përfshirë ndryshimet në teknologji, rindërtimin, dhe zgjerimin e objekteve ose ndërprerjen e operacioneve, të cilat mund të rezultojnë në ndikim të madh mjedisor ose që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut, kërkojnë Vlerësimin paraprak të Ndikimit në Mjedis (VNM). Procedura për zbatimin e një VNM gjithëpërfshirëse përshkruhet në ligjin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (08/L-181).

Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) rregullon procedurat për identifikimin dhe ekzaminimin e projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, dhe përveç kësaj, ai përshkruan aspektet, përmbajtjen, fushën e vlerësimit, raportimit dhe procedurat e administrimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të projekteve të propozuara për të siguruar të gjithë informacionin përkatës në lidhje me mjedisin, në mënyrë që të mundësohet dhe lehtësohet procesi i vendimmarrjes. Në bazë të vlerësimeve të ndikimit në mjedis, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI) lëshon pëlqimin e mjedisit të kërkuar për çdo projekt publik ose privat (të shënuar në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij Ligji), që ka të ngjarë të ketë efekte domethënëse në mjedis duke u mbështetur, ndër të tjera, në natyrën, madhësinë ose vendndodhjen e saj. Kryerja e procedurës së VNMS në përputhje me Legjislacionin e Kosovës paraqitet në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Ligji për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis (VSNM) (03 / L-230) synon të rreshtojë planet dhe programet e hartuara për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve. Ky ligj përcakton zhvillimin e një qasje të integruar për vlerësimin në përgatitjen e vlerësimeve për mbrojtjen e mjedisit drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ligji përcakton më tej se VSNM do të hartohet për plane ose programe që kanë potencial për një ndikim të madhë në mjedis, i cili përfshin ujë, burimet ujore dhe projektet e menaxhimit të mbeturinave. VSNM siguron një kornizë për zhvillimet e mëtutjeshme të projektit, të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me Ligjin për VNM. VSNM-të kryesisht janë zhvilluar nga autoritetet komunale, si një mjet për të siguruar një kornizë për menaxhimin e ndikimeve të mundshme mjedisore të zhvillimit të projekteve. Në përgjithësi, VSNM ka zhvilluar mjaftueshëm legjislacion sekondar dhe teknik për t'u zbatuar.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale rregullon procedurat dhe lëshimin, vlefshmërinë dhe aspektet e tjera të vlerësimit mjedisor në

nivel komunal. Raporti i Lejes Mjedisore Komunale kërkohet në bazë të shqyrtimit të Shtojcës II të Ligjit për VNM, kriteret e Shtojcës III dhe vendimet e MMPHI. Ka një shtrirje shumë më të ngushtë se VNM, është e kufizuar në 10 faqe dhe mund të përgatitet nga një person fizik.

Ligji mbi Ndotjen dhe Kontrollin e Parandalimit të Integruar (08/L-145) transponon Direktivën e BE-së 2008/1/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 janarit 2008 në lidhje me parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. Sidoqoftë, udhëzimet shoqëruese për teknikat më të mira të disponueshme dhe kufijtë e pranueshëm (emetimet, eficienta dhe të tjera) nuk janë përkthyer në Shqip, dhe, prandaj, nuk mund të jenë në përdorim të përgjithshëm, dhe projektet duhet të mbështeten në Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Bankës Botërore.

Sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (PKIN), subjektet e lejes së PKIN janë veprimtaritë industriale të përcaktuara në Shtojcën 1 të këtij ligji, si vijon:

- Një person do të operojë një instalim vetëm nën autorizimin e MMPHI;
- Kërkesa për leje duhet të paraqitet nga personi që do të ketë kontroll mbi funksionimin e instalimit pas autorizimit të lejes;
- Një aplikim te autoriteti kompetent për leje duhet të jetë me shkrim dhe të ketë një përmbajtje të përcaktuar në ligj.

## UJI

Kosova ka bërë përparim të mirë në miratimin e legjislacionit parimar dhe sekondar për sektorin e ujit. Primarë janë: (i) Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit; (ii) Ligji për Ujërat e Kosovës; (iii) Ligji për Rregullimin e Shërbimeve Ujore; dhe (iv) Ligji për Shëndetin Publik (në lidhje me cilësinë e ujit të pijshëm) që aktualisht janë në fuqi. Legjislacioni sekondar është miratuar gjithashtu në përputhje me direktivat e Komisionit Evropian dhe procedurat e licensimit, lejës dhe kontrollit përcaktohen në fushat e mëposhtme: (a) Administrimi i Burimeve Ujore; (b) Administrimi i Mbeturinave; (c) Planifikimi Hapësinor / Urban dhe Strehimi dhe Ndërtimi; (d) Mbrojtjen e Natyrës dhe Biodiversitetin; dhe (e) Mbrojtjen e Mjedisit. Autoriteti kombëtar përgjegjës për qeverisjen dhe menaxhimin e burimeve ujore është MMPHI e mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila monitoron gjendjen e mjedisit, përfshirë burimet ujore.

Përmbledhja e dokumenteve ligjore që rregullojnë aktualisht sektorin e menaxhimit të ujërave dhe ujërave të zeza në Kosovë përbëhet nga ligjet e mëposhtme parësore dhe dytësore:

- Ligji Nr. 04 / L-147 për Ujërat e Kosovës, ose Ligji i Ujërave;
- Ligji Nr. 05 / L-042 për Rregullimin e Shërbimeve Ujore, Ndryshohet / Plotësohet nga ligji Nr. 06/L-088;
- Ligji Nr.08 / L-048 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetësin Publike;
- Ligji Nr. 08 / L-094 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-09 për Ujitjen e Tokave Bujqësore;
- Udhëzimi Administrativ (UA) Nr.03 / 2018 "Për Procedurat për Leje Ujore";
- UA Nr. 15/2017 “për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit” Ndryshohet / Plotësohet nga ligji Udhëzimi Administrativ Nr. 11/22.
- UA Nr. 16 /2017 “për Klasifikimin e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë”;
- UA Nr. 17 /2017 “për Klasifikimin e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë”;
- UA Nr. 09/2017 "Udhëzim për Projektimin, Ndërtimin dhe Përdorimin e Digave";
- UA Nr. 05/2016 “për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore”;
- UA Nr. 04 /2016 “Për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërrjedhave dhe Akumulacioneve”;
- UA Nr. 06/2021 “për Strukturën e Pagesave të Ujit”;
- Rregullore Nr. 02/2016 “Për Mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së Pranueshme Ekologjike”;
- UA Nr. 19/2015 “për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave”;
- UA Nr. 02/2022 “për Kushtet, Mënyrat, Parametrat dhe Vlerat Kufizuese të Shkarkimit të Ujërave të Ndotura në Rrjetin e Kanalizimit Publik dhe në Trupin Ujor”;
- UA Nr. 12/2013 “Sistemi i Informimit për Ujëra”;
- UA Nr. 10/2021 (QRK) “për Cilësinë e Ujit të destinuar për Konsum Njerëzor”;
- Strategjitë, planet dhe dokumentet tjera:
  - Strategjia e Ujërave të Kosovës 2017 – 2036

## **Cilësia e Ajrit**

*Ligji për Mbrojtjen e Ajrit (Nr.08/L-025)* cakton përgjegjësinë për përcaktimin e standardeve të cilësisë së ajrit dhe emetimeve; identifikon treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit; dhe vendos detyrime për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Legjislacioni tjetër përkatës është:

- UA Nr. 16/2013 për Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit dhe Gazrat Serrë të Fluorura;
- UA Nr. 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit;
- UA Nr. 21/2013 për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin dhe Hidrokarburet Aromatike Policiklike në Ajër;
- UA Nr. 15/2010 për Kriteret për Përcaktimin e Pikave Monitoruese për Cilësinë e Ajrit, Numrin dhe Shpeshtinë e Matjeve, Klasifikimin e Ndotësve të Cilët Monitorohen, Metodologjinë e Punës, Formën dhe Kohën e Raportimit të të Dhënave;
- UA Nr. 07/2021 për Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Palëvizshme të Ndotjes.

## **Zonat e Mbrojtura Natyrore**

*Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233*, mbështetet në parimet e bashkëpunimit, qëndrueshmërisë, integritit, ndotësi-paguan, edukimin dhe shkollimin, përgjegjësinë dhe menaxhimin efektiv për ruajtjen e natyrës. Legjislacioni tjetër përkatës është:

- Ligji Nr. 08/L-137 për Pyjet në Kosovë;
- UA Nr. 18/2013 për Shpalljen e Rrjetit Ekologjik;
- UA Nr. 19/2013 për Vlerësimin e Pranueshmërisë së Planit, Programit ose Ndërhyerjes në Rrjetën Ekologjike;
- UA Nr. 12/2011 - për Llojet e Tipave të Vendbanimeve Natyrore, Hartat e Vendbanimeve Natyrore, Tipat e Vendbanimeve Natyrore të Rralla dhe të Kërcënuara si dhe Masat për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Tipave të Vendbanimeve Natyrore;
- UA Nr. 12/2020 për Shpalljen e Llojeve të Specieve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura;

- UA Nr. 01/2012 për Kushtet e Mbajtjes, Mënyrën e Shenjzimit dhe Evidentimit të Shtazëve të Mbrojtura në Internim;
- UA Nr. 07/2012 për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes të Regjistrit të Vlerave të Mbrojtura të Natyrës;
- UA Nr. 16/2012 (01.08.2012) për Vendkalimet e Shtazëve të Egra.

Strategjite, planet dhe dokumentet tjera:

- Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2021-2030;
- Strategjia për Menaxhimin e Kafshëve të Egra dhe Gjuetinë 2012-2022 (një plan afatgjatë për ruajtjen e ekosistemit dhe ekuilibrin ekologjik, mbrojtjen e duhur të kafshëve të egra, sigurimin e mirëqenies së tyre dhe kushteve për shfrytëzimin ekonomik të burimeve të tyre natyrore);
- Strategjia për Produktet Pyjore Jo-Drunore;
- Plani i Punës për Përzgjedhjen e Listave të Vendeve të Natura 2000, të dhënat e nevojshme, përgjegjësitë, afatet kohore dhe mjetet;
- Raporti Teknik: Identifikimi paraprak i vendeve në Natura 2000 në Kosovë (pikat aktive të biodiversitetit), etj.

Legjislacioni aktual nuk e mbështet lejen e veçantë, prandaj, për momentin e vetmja procedurë për lejimin e punimeve në Zonat e Mbrojtura të Natyrës është përmes procedurës së VNM-së. Për punë më të vogla, jashtë sferës së VNM-së, lejet nuk kërkohen. Sidoqoftë, projektet duhet të marrin parasysh kufizimet e përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e natyrës.

**Menaxhimi i Mbeturinave**

Ligji për Mbeturinat Nr. 08 / L-071 (2022) rregullon menaxhimin e mbeturinave, planet për menaxhimin e mjedisit, të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar që merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyrën dhe kushtet e mbledhjes së mbeturinave, transportit, trajtimit, përpunimit, deponimit dhe asgjësimit përfundimtar, importi, eksporti dhe transporti i mbeturinave, monitorimi, sistemi i informacionit dhe financimi. Mbetjet e rrezikshme menaxhohen gjithashtu sipas parashikimeve të Ligjit për Mbeturinat. MMPHI ka mandat të menaxhojë mbeturinat e rrezikshme, në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse.

## **Zhurma**

*Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02 / L-102*: Qëllimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Zhurma është të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë efektet e dëmshme (përfshirë shqetësimin për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës) të zhurmës në mjedis. Ky ligj ofron një bazë për zhvillimin e masave për të zvogëluar zhurmën e emetuar nga trafiku rrugor dhe hekurudhor, aeroplanët, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineritë e lëvizshme dhe burimet e tjera kryesore të ndotjes së zhurmës mjedisore dhe bezdisjes. Ligji (shpallur në vitin 2007) parashikon që Qeveria dhe komunat të hartojnë një Hartë Strategjike të Zhurmave dhe të përpilojnë Planet e Veprimit ndaj Zhurmave, por as ato nuk janë prodhuar deri më sot (Qershor 2019).

Legjislacioni tjetër nënligjor përkatës: Udhëzim Administrativ - Nr. 08/2009 për Vlerat e Lejuara të Emetimeve të Zhurmës nga Burimet e Ndotjes.

## **Ndryshimet Klimatike**

Për të zbatuar legjislacionin për ndryshimet klimatike, UA-të e mëposhtme janë miratuar:

- UA Nr. 19/2013 për Qasjen në Informacionin për Konsumin Ekonomik të Karburantit dhe Emetimet e CO<sub>2</sub> të Automjeteve të Reja Personale (1999/94/EC);
- UA Nr. 20/2013 për Zbatimin e Mekanizmave Fleksibil për Zhvillim të Pastër (2003/87/EC);
- UA Nr. 01/2016 dhe për Mekanizmin e Përcjelljes së Emisioneve të Gazrave Serë, miratuar më 29.01.2016.
- UA Nr. 09/2015 për Monitorimin e Emisioneve të Gazrave Serë; dhe
- Rregullore (BE) Nr. 525/2013 të Këshillit dhe Parlamentit European të 21 majit 2013 mbi një Mekanizëm për Monitorimin dhe Raportimin e Emetimeve të Gazrave Serë.

## **Trashëgimia Kulturore**

Sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore Nr. 02 / L-88, çdo ndërhyrje që mund të ndikojë në integritetin ose vlerën e trashëgimisë kulturore kërkon leje me shkrim nga institucioni kompetent. Institucioni kompetent do të urdhërojë ndalimin e menjëhershëm për një periudhë të pacaktuar të çdo lloj pune të paautorizuar në Trashëgiminë Kulturore. Kërkesa për leje për ndërtimin e ndërtesave ose zhvillime të tjera brenda Zonës Mbrojtëse të një monumenti arkitektonik, ose brenda një zone të ruajtjes arkitektonike duhet të paraqitet për shqyrtim në institucionin kompetent.

Institucioni kompetent ka të drejtën e vetos mbi dhënien e një leje të tillë. Nëse institucioni kompetent nuk i përgjigjet një aplikacioni për ndërtimin e ndërtesave ose zhvillimeve të tjera brenda 15 ditëve, leja mund të jepet nga autoriteti përkatës i planifikimit dhe ndërtimit. Ligji lejon çdo punë ndërtimore në vendet që mund të ndikojnë në vlerat kulturore, strukturën e objektit të trashëgimisë kulturore që është nën listën e mbrojtjes së përkohshme vetëm pas një leje me shkrim të institucionit përkatës.

### **Procedura e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Në përputhje me direktivat e BE-së dhe nenin 7 të ligjit Nr.08/L-181 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", kërkohet pëlqim mjedisor për çdo projekt publik ose privat të shënuar në Shtojcën I ose Shtojcën II të këtij Ligji, i cili ka të ngjarë të ketë efekte domethënëse në mjedis duke u mbështetur, ndër të tjera, nga natyra, madhësia ose vendndodhja e tij. Në bazë të të njëjtit ligj, të gjitha projektet që janë shënuar në Shtojcën I **do të jenë të detyruar të zbatojnë një VNM**, duke kërkuar autorizimin përkatës nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa projektet e listuara në Shtojcën II do të shqyrtohen një nga një dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Shtojcën III, në mënyrë që të përcaktohet nëse ata duhet të kërkojnë VNM. Është shumë e rëndësishme të përmendet që MMPHI nuk do të japë ndonjë pëlqim mjedisor të përmendur më lart derisa të realizohet një VNM në projekt dhe aplikantëve nuk do t'u jepet leje ndërtimi ose ndonjë leje tjetër (përfshirë IPPC) për projektet e përmendura më lartë dhe nuk duhet të fillojë të ekzekutojë ansjering nga ato, derisa të mos marrë një pëlqim mjedisor nga MMPHI. Vetëm në rastin e projekteve me qëllime të mbrojtjes kombëtare dhe me vendim të qeverisë, MMPHI mund të lejojë, për raste të veçanta, mos përfundimin e VNM-së. Prandaj, një VNM kërkohet për çdo lloj instalimi të ri ose të rinovuar siç përcaktohet në Shtojcën I të Ligjit Nr. 08 / L-181, paraqitur në Shtojcën I të këtij ligji.

Në përputhje me ligjin, procedura e VNM përfshin fazat e mëposhtme: (1) përzgjedhjen e projektit të VNM-së; (2) raporti i VNM-së; dhe (3) shqyrtimi i Raportit të VNM-së. Vetëm konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të përfshira në Raportin e VNM-së dhe në vendimin e propozuar për pëlqimin mjedisor (jo i gjithë raporti) i nënshtrohen debatit publik. Ministria do të jetë përgjegjëse për organizimin dhe planifikimin e debatit publik, i cili do të bëhet në bashkëpunim me aplikuesin dhe komunën ku zhvillohet projekti. Ministria përgatitë njoftimin për mbajtjen e debatit publik, duke përfshirë lokacionin e mbajtjes, datën dhe kohën e saktë, si dhe raportin e VNM-së. Të dhënat mbi detajet e vendit dhe kohës së saktë të mbajtjes së debatit publik do të ofrohen nga ana e aplikuesit.

### 3. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE EKZISTUESE MJEDISORE

Përshkrimi specifik i aspekteve mjedisore që i referohen vendndodhjes së saktë të zonës së Projektit dhe kushteve ekzistuese do të përcaktohen në këtë kapitull. Zona e studimit është në kuadër të komunës së Kamenicës. Kushtet bazë për burimet kryesore mjedisore janë analizuar dhe paraqitur për të përshkruar burimet e rëndësishme mjedisore dhe ndjeshmërinë e tyre në lidhje me zonën e projektit.

#### **Pozicioni Gjeografik dhe Topografia**


Komuna e Kamenicës gjendet në pjesën më lindore të Kosovës e cila kufizohet me: Medvegjën në veri-lindje, Bujanocin lindje, Leskovcin në lindje, Vranjen në lindje-jug, Gjilani jug-perëndim dhe Prishtina veri-perëndimore.

Ekziston një numër i madh i bizneseve të vogla në komunë. Më të Komuna e Kamenicës shtrihet në lindje të Kosovës. Kufizohet në jugperëndim me Komunën e Ranillugut, në perëndim me komunën Novobërdës, në veriperëndim me Prishtinën, në veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskocit, në lindje me Vranjen, si dhe në lindje e juglindje me Bujanocin. Sipërfaqja e K. Kamenicës është 417 km<sup>2</sup>. Pozita gjeografike e K. Kamenicës është periferike dhe në skajin me lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore, kryesisht të banuara me shqiptarë. Përmes magjistrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 30 km, ndërsa Prishtina 75 km nga Kamenica. Me Prishtinën mund të lidhet edhe me rrugë më të shkurtëra, duke e shfrytëzuar rrugën nëpër Novobërdë dhe Llabjan. Pra, në të dy drejtimet rruga shkurtohet për 50-55 km. Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc. Aeroporti më i afërt është ai i Prishtinës 90km dhe i Shkupit 130km. mëdhajat janë ndërmarrjet me pronësi shtetërore të cilat janë mbyllur apo funksionojnë nën kapacitetet e tyre. Shumica e këtyre ndërmarrjeve (janë privatizuar) merren me ndërtim dhe rindërtim (fabrika e tullave, fabrika e tjegullave, guroret, ndërtimtaria, metali, etj. Dy fabrikat më të mëdha në komunë, ajo e tullave dhe e përpunimit të magneziumit, nuk janë duke punuar. Të punësuar janë afro 700 punëtorë në sektorin publik dhe afro 1.700 në sektorin privat. Në Dardanë, nga autoritetet përkatëse, janë dhënë lejet për shfrytëzimin e resurseve natyrore si rëra dhe zhavorri. Më 2000, këto leje i kanë sjellur komunës të ardhura prej afro 250,000 Eurove. Ndërmarrja publike më profitabile është XIM Strezoc, që ka furnizuar KFOR-in amerikan me zhavor që arrin vlerën e disa miliona eurove. Transporti - Rrugët ndër-urbane janë në gjendje të mirë. Me ndihmën e Ministrisë së Telekomunikacionit është arritur të shtrohen 2 rrugë me rëndësi. Rruga Kamenicë - Prishtinë (përmes Novo bërdës) dhe Kamenicë - Tygjec një rrugë që u ka dhënë shpresë qytetarëve për një jetë më të mirë. Deri në fund të vitit 2008 Kamenica do të




përfitojë edhe 2 rrugë të reja njëra në drejtim të Krilevës që vazhdon më pas për në Prishtinë dhe tjetra në drejtim të Kapisë që shpie për në komunën fqinje të Medvegjës. Këto rrugë do të hapin perspektiva të reja duke e lidhur kështu qytetin me nyje të rëndësishme ekonomike. Kështu që MPTK-së, në vitin 2007, asfaltoi rrugën Kamenicë – Tugjec, me gjatësi prej 18 kilometrash.

**Lokacioni i zgjerimit të vëndshfrytëzimit te argjilës "Brickos"sh.p.k, gjendët në fshatin Topanicë, Komuna Kamenicë, me koordinatat 42°31'19"N, 20°37'04".**



*Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Kamenicës*

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, Komuna e Ranillugut i takon hapësirës së verdhë, e cila paraqet pjesën jug-lindore të Kosovës. Ka karakteristika të rajonit të kombinuar nga qendrat urbane dhe më shumë të atyre rurale, me tokë bujqësore të kualitetit të lartë, me resurse të ujërave minerale, hapësira të lira të gjelbra, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike - malore, transitore dhe shëndetësore, që kanë ekzistuar prej kohësh. Hapësira e verdhë, ku bënë pjesë edhe komuna e Ranillugut shtrihet në fushën e Anamoravës.



*Figura 2. Pozita gjeografike e komunës së Ranillugut në hartën gjeografike të republikës së Kosovës*

Komuna e Ranillugut shtrihet në një hapësirë të rrafsh me kodra, nëpër të cilat rrjedh lumi Morava. Komuna është afër luginës së Moravës dhe maleve të zeza të Skopisë. Sipërfaqja e komunës përfshinë 77,62 km<sup>2</sup> dhe ka 13 zona kadastrale dhe fshatra. Komuna e Ranillugut është formuar në territorin më parë të përfshirë në komunën e Kamenicës. Komuna e re është formuar më 05.01.2010 me planin e Ahtisarit për decentralizim në territorin e Republikës së Kosovës.



Figura 3. Harta Topografike e zgjërimit të vendshfrytëzimit të argjilës, Topanicë-Kamenicë.

### Kushtet Klimatike

Komuna e Kamenicës ka klimë të mesme kontinentale, me verëra të nxehta dhe dimëra të ftohtë. Temperatura mesatare e janarit është  $-1^{\circ}\text{C}$ , ndërsa ajo e korrikut  $21.50^{\circ}\text{C}$ . Temperaturat maksimale absolute janë në muajin gusht  $+37^{\circ}\text{C}$ , kurse minimale absolute janë në janar  $-32^{\circ}\text{C}$ . Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m<sup>2</sup>. Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te Dheu i Bardhë, kurse ajo më e larta është 1223 m te Guri i Zi (f.Tërstenë). Lagështia e ajrit – vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84 %. Reshjet – sasi të mesatare vjetore të të reshurave në komunën e Kamenicës arrijnë 596l/m<sup>2</sup>, ndërkaq në zonën malore shtohen në 800 l/m<sup>2</sup>. Muajt më të pasur me shi, janë nëntori dhe maji me 76.1 dhe 71.9 l/m<sup>2</sup>, kurse në viset malore muaji i dhjetorit me 101.0 l/m<sup>2</sup>. Muaji më i thatë është korriku dhe gushti. Erërat – Në Komunën e Kamenicës erërat më të shpeshta janë ato veriore dhe më të rrallat janë ato jug – përendimore, kurse shpejtësia mesatare e erës është 3m/sek. Komuna e Kamenicës ka klimë të mesme kontinentale, me verëra të nxehta dhe dimëra të ftohtë. Temperatura mesatare e janarit është  $-1^{\circ}\text{C}$ , ndërsa ajo e korrikut  $21.50^{\circ}\text{C}$ . Temperaturat maksimale absolute janë në muajin gusht  $+37^{\circ}\text{C}$ , kurse minimale absolute janë në janar  $-32^{\circ}\text{C}$ . Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m<sup>2</sup>. Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te Dheu i Bardhë, kurse ajo më e larta është 1223 m te Guri i Zi (f.Tërstenë). Lagështia e ajrit – vlera mesatare vjetore e

lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84 %. Reshjet – sasi të mesatare vjetore të të reshurave në komunën e Kamenicës arrijnë 596l/m<sup>2</sup>, ndërkaq në zonën malore shtohen në 800 l/m<sup>2</sup>. Muajt më të pasur me shi, janë nëntori dhe maji me 76.1 dhe 71.9 l/m<sup>2</sup>, kurse në viset malore muaji i dhjetorit me 101.0 l/m<sup>2</sup>. Muaji më i thatë është korriku dhe gushti. Erërat – Në Komunën e Kamenicës erërat më të shpeshta janë ato veriore dhe më të rrallat janë ato jug – përendimore, kurse shpejtësia mesatare e erës është 3m/sek. Në territorin e Komunës së Kamenicë nuk ka erëra të forta, të cilat do të rrezikonin popullatën e Kamenicës dhe ekonominë e saj. Ndër erërat që njihen në këtë komunë janë:

1. Era jugore (Era e Karadakut) me shpejtësi  $v=3.2$  m/s
2. Era veriore me shpejtësi  $v=3.3$  m/s
3. Era veriperëndimore (Prishtinka) me shpejtësi  $v=2.5$  m/s
4. Era lindore (Vllasinka) me shpejtësi  $v=2.5$  m/s
5. Era jugperëndimore me shpejtësi  $v=2.5$  m/s




Figura 4. Trëndafili i erës në Kamenicë




Figura 5. Trëndafili i erës në Ranillug.

2008	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	m.vjet.
<b>Tmax.</b>	3.4	10.0	13.0	17.0	22.2	26.5	28.0	30.3	21.2	18.4	11.6	6.6	<b>18.7</b>
<b>Tmin.</b>	-2.3	-1.9	1.7	5.9	8.0	12.2	13.9	13.8	8.9	6.2	2.7	-1.8	<b>5.6</b>
<b>Tmes.</b>	0.8	3.5	7.2	11.6	15.7	19.8	21.0	21.9	14.8	11.8	6.9	3.4	<b>11.5</b>
<b>Lagësh. %.</b>	86	78	72	67	70	73	66	59	73	80	82	82	<b>74</b>
<b>Shtypja.at</b>	950.7	953.6	938.2	947.6	946.0	946.6	946.0	942.2	946.5	950.3	947.1	947.3	<b>946.8</b>
<b>Era/ms.</b>	0.9	0.7	1.5	1.3	0.8	0.7	0.7	0.4	0.5	0.8	1.1	2.1	<b>0.9</b>
<b>Reshjet.</b>	<b>13.5</b>	<b>21.7</b>	<b>88.8</b>	<b>25.2</b>	<b>46.5</b>	<b>64.8</b>	<b>64.1</b>	<b>5.3</b>	<b>50.4</b>	<b>23.5</b>	<b>59.7</b>	<b>94.8</b>	<b>46.5</b>

Tabela 1. Temperaturat mesatare dhe reshjet në komunën e Kamenicës

Si rezultat i pozitës gjeografike që e ka komuna e Ranillugut dhe ndryshimeve klimatike, përkatësisht të temperaturave në tërë globin, është ndikuar që valorizimet klimatike në territorin e komunës së Ranillugut të jenë të ndryshme. Sipas të dhënave klimatike nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, duke filluar nga viti 2002 dhe deri te viti 2008, regjistrojmë rritje të temperaturës në tërë regjionin e Gjilanit. Në tabelën 1 kemi paraqitur reshjet për vitin 2008, përfshirë temperaturat mesatare, lagështia në %, shtypja atmosferike dhe erërat në m/s.

Tabela 2. Vlerat mesatare për reshjet në vitin 2008, temperaturat mesatare, lagështia në %, shtypja atmosferike dhe erërat në m/s.

2008	I	II	III	IV	V	VI	VI I	VI II	IX	X	XI	XII	Mes.vj et.
<b>T °Cmax</b>	3.4	10.0	13.0	17.0	22.2	26.5	28.0	30.3	21.2	18.4	11.6	6.6	<b>18.7</b>
<b>T °Cmin</b>	-2.3	-1.9	1.7	5.9	8.0	12.2	13.9	13.8	8.9	6.2	2.7	-1.8	<b>5.6</b>
<b>T°Cmes</b>	0.8	3.5	7.2	11.6	15.7	19.8	21.0	21.9	14.8	11.8	6.9	3.4	<b>11.5</b>
<b>Lagështia %</b>	86	78	72	67	70	73	66	59	73	80	82	82	<b>74</b>
<b>Shtypja atm</b>	950.7	953.6	938.2	947.6	946.0	946.6	946.0	942.2	946.5	950.3	947.1	947.3	<b>946.8</b>
<b>Era/ms</b>	0.9	0.7	1.5	1.3	0.8	0.7	0.7	0.4	0.5	0.8	1.1	2.1	<b>0.9</b>
<b>Reshjet</b>	<b>13.5</b>	<b>21.7</b>	<b>88.8</b>	<b>25.2</b>	<b>46.5</b>	<b>64.8</b>	<b>64.1</b>	<b>5.3</b>	<b>50.4</b>	<b>23.5</b>	<b>59.7</b>	<b>94.8</b>	<b>46.5</b>

## Kualiteti i Ajrit

Monitorimi i cilësisë së ajrit kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), i cili menaxhon të gjitha stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë. Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit përbëhet nga 12 stacione automatike fikse dhe një stacion automatik i lëvizshëm. Shpërndarja e stacioneve dhe përzgjedhja e vendndodhjeve të monitorimit është bërë në përputhje me kriteret e Direktivës 2008/50/BE për ajrin e pastër në Evropë dhe ligjet vendore. Në bazë të kriterëve të mësipërme, stacionet janë të shpërndara në 9 (nëntë) komuna të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Obiliq, Drenas, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Shtërpçë (Brezovicë), Han të Elezit dhe Gjiilan.

Në komunë të Kamenicës nuk ekziston matës të ndotjes së ajrit. Ajri është më i ndotur në qendrën urbane, ndotje që shkaktohet nga pluhuri, si pasojë e djegies industriale dhe trafiku (gazrat e liruar nga makinat e vjetra dhe pa katalizator). Ndotja e ajrit shkaktohet nga përdorimi i lëndëve të ndryshme djegëse, në mungesë të imiantit qendror të ngrohjes për qytetin. Harta në figurën më poshtë tregon zonat kryesore të ndotjes së mundshme të ajrit nga gjithë faktorët që i përmendem më lart ajrit në Kamenicë. Ato janë në rrugët kryesore ku ka përqendrim të lartë të ndotjes nga automjetet dhe zonat tjera të ndotjes.




Figura.6. Harta - Zonat nën ndikimin e mundshëm të ndotjes së ajrit ne Kamenicë

## Zhurma

Në Komunën e Kamenicës burim kryesor i zhurmes është komunikacioni, Industria e cila zhvillohet në mënyrë të shpërndarë brenda vendbanimeve, gurëthyesit të cilët zhvillojnë një bezdisje të vazhdueshme. Ndërsa si zhurma tjera të cilat zhvillohen nga pakujdesia e të cilat janë akute zhvillohen në gjitha pjesët e komunës duke e prishur rendin dhe qetësinë publike.

## Gjeologjia

Kosova ka një gjeologji të larmishme që varion në moshë nga neo-proterozoiku deri në holocen. Gjeologjia është e karakterizuar nga tipare substanciale strukturore në shkallë regjionale, duke përfshirë shkarjet (shkëputjet) normale dhe thyerjet. Një thjeshtim i përgjithshëm i sekuencës stratigrafike është si më poshtë.

Një thjeshtzim i përgjithshëm i sekuencës stratigrafike paraqitet si vijon:

- Holoceni: depozitime shpatore të formuara nga alterimi i materialit shkëmbor nga viset malore dhe aluvionet e depozituara nga lumenjtë.
- Plioceni: silicor andezitik.
- Mioceni i Sipërm – Plioceni: formimi i linjitet nga akumulimi dhe më pas shpërbërja graduale e vegjetacionit në pellgjet sedimentare.
- Oligo-Mioceni: konglomerate, argjila dhe gëlqerorë, të shoqëruar nga magmatizmi acidik deri në mesatar.
- Molase të Kretakut të Vonshëm: karbonate të ujërave të cekëta dhe shkëmbinj klastik (copëzor).
- Flish i Kretakut të Sipërm: gëlqerorë mergelor, ranorë dhe konglomerate.
- Kretaku i Hershëm: konglomerate, ranorë dhe alevrolite.
- Jurasiku i Vonshëm: Gëlqerorë masiv.
- Triasik-Jurasik: magmatizmi bazik dhe acid, i shoqëruar nga riftimi i korës ofiolitike dhe obduksioni i shkëmbinjve ultrabazikë.
- Triasik: shkëmbinj klastik dhe vullkanikë që kanë mundësuar platformat karbonatike të shndërrohen në dolomite, disa prej të cilëve janë të metamorfizuara në mermer.
- Permo-Triasiku: shkëmbinjë karbonatik, klastik, filit, rreshpe(shiste) dhe kuarcite që janë vërsuar nga magmatizimi acid (kuarc porfirit).
- Palaeozoik i Vonshëm: rreshpe.

Formimi i përgjithshëm i zonës së gjerë të Projektit përfshin shkëmbinj të moshave të ndryshme: depozitime të Holocenit, Pleistocenit, Pliocenit, Kretaku dhe Jurasikut.




Figura 7. Harta Gjeologjike e Kosovës.

## Hidrologjia

Në Kosovë ka shumë lumenj që rrjedhin drejt Detit Adriatik, Detit të Zi dhe Detit Egje. Lumenjtë kryesorë të Kosovës janë Drini i Bardhë (në pjesën jugore të Kosovës - derdhet në detin Adriatik), Lumi Ibër (në pjesën veriperëndimore derdhet në lumenjtë Morava dhe Danub dhe më tej në Detin e Zi), Lumi Lepenc (në pjesën juglindore derdhet në lumin Vardar dhe në detin Egje). Lumenjtë tjerë të rëndësishëm në Kosovë janë: Lumi Sitnica, Morava e Binçës, Bistrica e Pejës dhe Bistrica e Deçanit. Kosova gjithashtu ka një numër të madh të burimeve karstike, burimeve të ujërave termale dhe minerale, luginave akullnajore dhe liqeneve natyrore dhe artificiale.

Shikuar në tërësi, gjendja e rregullimit të ujërrjedhave dhe mbrojtja nga vërshimet në territorin e Kamenicës është e pavolitshme. Edhe pse në periudhën e kaluar janë bërë disa punë për rregullimin e ujërrjedhave të shumta, përsëri kohë pas kohe kanë Plani Zhvillimor Komunal – Kamenicë 64 ndodhur vërshime të intensiteteve të ndryshme, të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në amvisni dhe shumë degë të ekonomisë. Kjo gjendje është pasojë, para së gjithash e faktit se gjatë aktiviteteve për rregullimin e ujërrjedhave dhe mbrojtjes nga vërshimet, më shumë janë bërë punë të karakterit parcial. Mirëpo, intensiteti i realizimit të këtyre punëve edhe më tutje është i pavolitshëm. Situatën më së shumti e rëndon mirëmbajtja e dobët dhe kontrolli i pamjaftueshëm i objekteve mbrojtëse përgjatë lumenjve, si dhe puna e



pamjaftueshme huluntuese dhe studimore. Lumi dhe përroskat në Kamenicë nuk janë të rregulluar ashtu, që të mund ti pranojnë prurjet (rritje e pakontrolluar e nivelit të ujit) dhe si pasojë janë përmbytjet me përmasa të mëdha. Në bazë të shënimeve të sistematizuara (master planit të vitit 1986), gjatësia e lumit dhe përroskave që rrezikojnë të vërshojnë është 94.36km. Prej këtyre deri më tani, janë rregulluar vetëm rreth 3 km apo rreth 3.17 %. Nëpër territorin e komunës së Ranillugut rrjedh lumi Morava e Binçës që mbledh të gjithë lumenjtë e vegjël me rrjedh mesatare të ujit prek  $6.7 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

Morava e Binçës është pjesë e burimit të Moravës jugore. Buron në Malet e Karadakut (Malet e Zeza) në territorin e Maqedonisë, në jug të Vitisë e në veri të Shkupit. Emrin e ka marr nga vendbanimi Binçë. Gjatësia e këtij lumi në territorin e Kosovës është 60 km ndërsa sipërfaqja e basenit është  $1.560 \text{ m}^2$ , kurse rrjedha mesatare e saj në dalje të territorit të Kosovës është  $11.0 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

Prurja mesatare mujore në Moravën e Binçës në mënyrë të theksuar fillon të rritet në muajin shkurt, kur prurja është më e madhe se ajo e janarit për  $2,89 \text{ m}^3/\text{sek}$  në Domoroc dhe  $356 \text{ m}^3/\text{sek}$  në Korminjan. Krahasuar me muajin shkurt-mars kjo prurje në lokalitetin e parë është më e madhe për  $2,35 \text{ m}^3/\text{sek}$  e në Korminjan për  $2,20 \text{ m}^3/\text{sek}$ , kur në këto lokalitete arrin lartësia më e madhe e prurjes, në muajin mars. Minimumi i prurjes është shënuar në muajin gusht në të dy lokalitetet.



Figura 8. Hidrologjia e Kosovës dhe zona e projektit (e rrethuar me të kuqe) (Burimi: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale).

## Kualiteti i Ujërave

Territori i Komunës së Kamenicës ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Në komunë janë tre lumenj: Krivareka me degët e saja lumë burimor, Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojcës. Lumi “Kriava Reka” buron në malet e Gollakut dhe deri në hyrje të fshatit Hajnoc, i takon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë (lum i pastër). Prej fshatit Hajnoc e deri në hyrje të Kamenicës, i takon shkallës së dytë (ndotje e lehtë). Pas daljes nga vendbanimi i Kamenicës e deri në bashkimin me Lumin “Morava”, shndërrohet në lumë me ndotje të kategorisë dytë (ndotje e lartë). Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak leshohen në Lumin “Kriava Reka” dhe rritë shkallën e ndotjes së lumit. Lumi i Hogoshtit është i pastër deri në hyrje të vendbanimeve (ujra burimore), pas shkarkimit të ujërave të zeza dhe hudhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve kalon në shkallën e ndotjes dytë. Lumi i Desivojcës deri në vendbanimin e Shipashnices së Epërme i takon shkallës së parë të pastërtisë, nga aty e deri në Moravë i takon shkallës më të lartë të ndotjes. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak, rritë shkallën e ndotjes së lumenjve. Çdo banor shkarkon  $16.46\text{m}^3$  ujëra të zeza. Vetëm Kamenica si qytet me 7334 banorë, shkarkon  $6.5\text{ l/s}$  ose  $47671\text{ m}^3/\text{vit}$  ujëra të zeza të patrajuara në lumë brenda vitit, pa llogaritur këtu objektet shoqërore, industriale etj. Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpërlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, nga objektet industriale etj. Rekomandohet për Komunën e Kamenicës që të përcaktohet për variantin e parë, ku komuna të ndajë sipërfaqe tokësore për ndërtimin e një impianti në mes të fshatit Korminjan dhe Dheut të Bardhë. Arsye është, përshkak të konfiguracionit të terrenit.

## Menaxhimi i Mbetjeve

Shërbimi bazë që komunat dhe operatorët e licencuar ofrojnë për qytetarët në Kosovë lidhur me mbeturinat komunale është grumbullimi përfundimtar, transporti dhe deponimi në deponitë sanitare. Harta e mëposhtme jep një pasqyrë të nivelit të mbulimit me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve sipas komunave.




Figura 9. Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Kamenicës.

Me analizat e bëra nga grupet punuese dhe kompania “Univerzal”, si dhe aktorë tjerë është parashikuar: që të ndërtohen deponi tranzite të mbeturinave inerte (ndërtimtarisë) gati në të gjitha fshatrat, janë planifikuar deponi tranzite të mbeturinave komunale në çdo lokalitet. Parashikohen intervenime te vendi i deponisë së vjetër të qytetit (rehabilitimi i zonës dhe izolim, ngjashëm është planifikuar që të bëhet edhe rehabilitim i vendit ku janë rialokuar mbeturinat e deponisë së vjetër në fshatin Koretin. Parashikohet grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave, që janë hudhur në mënyrë të pa kontrolluar me prioritet në brigjet e Lumit “Kriva Reka”, Lumit të Hogoshtit, Lumit të Desivojcës dhe në hapësira të ngjashme. Parashikohet në vendbanimet ku nuk ka fare menaxhim, të futen në sistem të menaxhimit të mbeturinave, mandej në vendbanimet të cilat janë pjesërisht nën sistem të menaxhimit të mbeturinave që të futen nën menaxhim të plotë, kurse vendbanimet në të cilat bëhet menaxhimi i mbeturinave të fuqizohet sistemi i menaxhimit përmes infrastrukturës dhe elementeve tjera përbërëse. Aktualisht, qyteti e ka strategjinë për trajtimin e mbeturinave, duke u bazuar në parimet e kontrollit dhe të vendosjes në vend të sigurtë. Hedhja e mbeturinave bëhet nëpër kontejnerë të mëdhenj e të vegjël, nëpër vende të caktuara, ku më pas bëhet bartja e tyre në deponinë qendrore në afërsi të qytetit të GJILANIT. Përveç qytetit dhe lokaliteteve si në Berivojcë, Koretin dhe Rogaçicë, në vendbanimet tjera të komunës nuk bëhet fare menaxhimi i mbeturinave si dhe trajtimi i tyre. Vendi i mëparshëm ku është bërë deponimi i mbeturinave, është mbuluar dhe kthyer në gjendje të rikultivueshme. Problem më vete janë vajrat e

ndërruara të automjeteve , gomat e vjetra, thaset e najlonit, shishet e plastikes , lirimi i gazrave nga automjetet e vjetruara.

### Përmbytjet

Pothuajse të gjitha komunat e Kosovës, pak a shumë, janë të prekura nga rreziku nga vërshimet të cilat manifestohen në formën e: vërshimeve pas stuhive në zonat malore, vërshimeve pas reshjeve të dendura në zonat fushore, vërshimeve pas shkrirjes së borës të shoqëruara ose jo me mot të ftohtë.<sup>1</sup> Përmbytjet sipas pellgjeve lumore: Drini i Bardhë: 50 % Ibri: 24 %, Lepenci: 20 %, Morava e Binçës: 6 %. Dëmet më të konsiderueshme të shkaktuara nga përmbytjet janë shënuar në pellgun e lumit Drini i Bardhë 50,7 %. Dëmet e shkaktuara nga përmbytjet vetëm nga lumi Drini i Bardhë arritën në 9.7 %.




Figura 10. Rreziqet nga përmbytjet në Kosovë ku zonat e kuqe tregojnë zona të cilat janë shumë të ekspozuara ndaj përmbytjeve, me rrezik mesatar – ngjyra e verdhë, ndërsa me rrezik të ulët – ngjyra e gjelbërt (burimi: Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyror).

Komuna e Kamenicës ka një rrjet lumenjsh, por më të rëndësishmit janë : Lumi “Kriva Reka”, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës . Të gjithë këta lumenj derdhen në

Lumin Morava në këtë komunë ekziston dhe liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjtë e Kamenicës rrjedhje më të mëdha kanë gjatë muajit shkurt ,mars dhe maj, kurse rrjedhje më të vogla gjatë muajit gusht dhe shtator. 168 Plani Zhvillimor Komunal - Kamenicë Komuna e Kamenicës është e pasur me burime ujore. Në bazë të të dhë dhënave të Bazës së Hidroekonomisë së Kosovës, në territorin e Kamenicës janë të rrezikuara rreth 1100 ha. Në territorin e saj ujërat sipërfaqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 1021 ha ose 1.97% e sip. të përgjithshme e komunës.




Figura 11. Vërshimet dhe Erozionet në Komunën e Kamenicës.

### Rrëshqitjet e dheut dhe Erozioni

Bazuar në strukturën litologjike, tektonike, morfologjike, klimatike, hidrologjike të tokës, mund të konstatohet se shumë pjesë të territorit të Kosovës janë të mbuluara nga një sërë procesesh ekzodinamike, të përfaqësuara kryesisht nga terreni i rrëshqitjes së dheut. Krahas të tjerave, dukuritë e rrëshqitjeve shfaqen në pjesën e

poshtme të tokës në zonat e pellgjeve neogjene (Dukagjin, Llap, Drenicë, Morava e Binçës) dhe pjesë të tjera. Sipas hartës së erozionit të Kosovës të paraqitur në figurën më poshtë mund të konstatohet se zona e projektit është në zonën ku nuk ka ndonjë rrezik të madh nga erozioni.





Figura 12. Harta e erozionit dhe lokacioni i projektit (rrethuar me të kuqe) (burimi: AMMK).

Edhe në territorin e Komunës së Kamenicës është prezent faktori natyror erozioni, që për pasojë ka humbjen e tokës bujqësore dhe dëmet në ekonomitë familjare. Nga një shkallë e lartë e rrezikshmërisë erozive janë të përfshira 25050 ha ose 48% e sipërfaqes së komunës, që i takojnë shkallës me erozion të fortë dhe shumë të fortë. Shkalla e rrezikshmërisë është në rritje, si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri. Nga shkalla më e lartë e rrezikshmërisë që e ka kategoria e erozionit shumë të fortë, janë të përfshirë 11550 ha tokë.




Grafiku 1. Shkalla e erozionit në Komunën e Kamenicës.

### Përdorimi i Tokës


Në komunë dominon shfrytëzimi bujqësor i tokës me 45.57% të territorit të përgjithshëm dhe pyjor me 41.82%, që paraqet një tregues shumë të rëndësishëm drejtë politikave zhvillimore ekonomike.

Tokë e punueshme – Ara	12284 ha
Kullosa	<b>7365.3691</b> ha
Livadhet	<b>2842.3312</b> ha
Pemë dhe perime	197 ha
Vreshta	1.0 ha
Male	<b>16510.1305</b> ha
<b>Totali</b>	<b>39199.8308</b> ha

Tabela 3. Ndarja e tokave sipas kulturave ne komunën e Kamenicës.



Grafiku 2. Përdorimi i tokës në komunën e Kamenicës (PZHK 2013-2023+).



Grafiku 3. Shfrytëzimi i tokës në Kamenicë.

Shfrytëzimi i tokës bujqësore dominon me 15,626.5 hektarë, bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik dhe sektor që siguron më së shumti të hyra, sepse 2/3 e popullsisë jeton në zonat rurale. Sipas vlerësimit të tokës bujqësore, rezulton se 44.89 % e territorit është tokë bujqësore, 0.59 % djerrinë dhe 0.08 % kullosë/livadh.

Sipërfaqja e gjithmbarshme e tokave pyjore në komunë e Ferizajt është 14,343.27 ha, ku 64 % është pronë publike dhe 34 % është pronë private. Sa i përket shfrytëzimit të tokës së ndërtuar, dominon banimi individual me gjithsej 2498.18 ha, që përfshin edhe ndërtesat përcjellëse, bujqësore, deponuese apo garazhe. Në anën tjetër 0.41 % e territorit të komunës është e shfrytëzuar nga ujërat sipërfaqësor, përderisa sa i përket rrugëve 80 ha janë rrugë vendbanimi urban, 146.8 ha vendbanimesh rurale dhe 688 ha të tjerë, që nuk janë rrugë vendbanimore.

Një përqindje e ulët e sipërfaqes së tokës është shfrytëzuar për vijën hekurudhore që përshkon komunën. Janë gjithsej 44 ha, mbi të cilat shtrihet rrjeti hekurudhor, që kalon nëpër këto vendbanime: Varosh, Nikadin, Gurëz, Ferizaj, Bablak, Babush, Kosine, Lloshkobare dhe Prelezi Jerlive.

## Biodiversiteti

Edhe pse Kosova është një vend i vogël, ajo njihet për biodiversitetin e saj të pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, dhe relievi janë disa nga faktorët që i kanë mundësuar Kosovës të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor me një larmi të mirë floristike, vegjetative dhe faunale, ku vlen të theksohet



prania e specieve: relike, endemike si dhe specie me rëndësi të veçantë. Kosova ende nuk ka një inventar të plotë të biodiversitetit. Kamenica si edhe shumica e vendeve të Kosovës po përballen me problemin e humbjes së biodiversitetit. Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënim serioz për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore, padyshim është faktori njeri; ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit, si dhe gjuetia e pa kontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë që vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja e sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë me të madhe ekosistemin natyror, është një nga problemet më emergjent për natyrën e Kamenicës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur, kryesisht si pasojë e shfrytëzimit pa kritere të zonave pyjore. Si pasojë e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukje të shumë llojeve bimore dhe shtazore. Kafshët e rralla në vendin tonë si: ujku, derri i egër, kaprrulli, dhelpra, vjedulla, dreri, dhia e egër, macja e egër, lepuri, ketri, thëllëza, shqiponja, petriti, pata e egër, lejleku etj. janë rrezikuar të pakësohen si pasojë e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve të tyre, si gjuetisë së pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit të ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese, sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës së riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjatë fazës së lulëzimit dhe nxjerrja me rrënjë. Bazuar nga të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) respektivisht sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), por edhe sipas observimeve në terren, në afërsi të lokacionit ku gjendet fabrika nuk ka zona të mbrojtura. (AMMK-IKMN 2008, 2010).

### **Zonat e mbrojtura natyrore**

Kosova brenda territorit të saj të vogël është e pasur me vlera të larta natyrore. Dekadën e fundit në Kosovë po bëhet përparim në fushën e ruajtjes së natyrës. Mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura është një mjet i rëndësishëm ligjor që mundëson mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit. Aktualisht numri i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë është 184 dhe përfshin një territor prej 126,119.29 ha, ose 11.56 % të territorit të Kosovës. Këto zona përfshijnë: 19 Rezervate Strikte Natyrore (“Rezervati i Arnenit”, “Maja e Ropsit”, “Rusenica”, “Kamilja” etj.), 2 Parqe Kombëtare (PK “Sharri”, PK “Bjeshkët e Nemuna”), 157 Monumentet e Natyrës (“Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit”, “Shpella e Gadimës”, “Ujvarat e Mirushës”, “Gryka e Rugovës”, “Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë”, “Trungu i Rrapit” në Marash etj.), 1 Park Natyror (“Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës”), 4 Peizazhe të Mbrojtura (“Shkugëza” dhe “Pishat e Deçanit” etj.) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Shpendëve (“Ligatina e Hencit- Radeves”). Territorin më të madh të zonave të mbrojtura e zënë Parqet Kombëtare: “Bjeshkët e

Nemuna” dhe “Sharri”, Parku Natyror “Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës”, Peizazhi i Mbrojtur “Gërmia” dhe “Ujëvarat e Mirushës”, etj.

Bazuar nga të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AKMM) respektivisht sipas Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), por edhe sipas observimeve në terren, në afërsi të lokacionit ku gjendet shfrytë zimi i argjilë s për prodhimin e bllokave nga argjila nuk ka zona të mbrojtura. (AMMK-IKMN 2008, 2010).




Figura 13. Harta e zonave të mbrojtura në Kosovë (zona e projektit e rrethuar me të kuqe).

## Mjedisi Social

### Demografia

Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të vitit 2011, Komuna e Kamenicës ka 57 vendbanime poashtu edhe sipas zonave kadastrale, ku jetojnë 40224 banorë. Pjesa më e madhe me 57.20% i takon grup-moshës 20 - 64 vjeçare.

Mosha	Nr. i popullsisë	%
Prej 0 – 6	6821	16.95%
Prej 7 – 15	6092	15.15%
Prej 16 – 19	2483	6.19%
Prej 20 – 40	10756	26.74%
Prej 41 – 65	12256	30.46%
Mbi 65	1816	4.51%
<b>Totali</b>	<b>40224</b>	<b>100%</b>

Tabela 4. Numri i banorëve sipas grup-moshave.

Mbi 34 % të popullsisë së përgjithshme në komunë, janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç; ndërsa grup moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël, rreth 5% të popullsisë së përgjithshme. Në Komunën e Kamenicës, sipas regjistrimit të 2011 të siguruara nga grupet punuese për përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal jetojnë 40224 banorë në sipërfaqe prej 417 km<sup>2</sup>. Pjesa dërmuese e popullsisë në këtë komunë jeton në fshat 81,69 %. Vetëm 18,31 % e saj jeton në qendrën e vetme urbane të kësaj komune, me qendër në Kamenicë. Plani Zhvillimor Komunal – Kamenicë në këtë komunë, gjithashtu dominon banimi i karakterit individual, pasi që, vetëm në qendrën urbane janë të ndërtuar një numër i vogël i banesave shumfamiljare, të karakterit kolektiv. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Kamenicës, është rreth 8230 nga e cila shumë, 6896 objekte, ose 83,79 % janë të ndërtuara në zonat rurale, 1334 objekte të banimit, ose 16,21 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane.

### Ekonomia

Ekzistimi i resurseve natyrore (bentoniti, deltina, argjila, tufi, kuarci, leuciti, thëngjilli silikoni, antimoni, çeliku hekuri etj). Ekzistimi i zonave të veçanta industriale prodhuese dhe planifikimi i disa zonave të tilla, (Zona industriale Berivojcë, Topanicë dhe disa vendbanime e hapësira me mundësi industriale) Tradita industriale (industria e përpunimit të lëngjeve, qeramikës, materialeve ndërtimore, drurit etj) Resurset njerëzore Interesi i sektorit privat dhe mundësitë e investimeve

nga jashtë Ekzistimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme prodhuese Ekzistimi i një infrastrukture (rruga, rryma etj...) Procesi i privatizimit (disa ndërmarrje si, XIQ "Karaçeva", XIM Strezoci, Niteksi janë privatizuar) Ekzistimi i kushteve për zhvillimin dhe kultivimin e kulturave bujqësore në prodhimin e drithërave Ekzistimi i tokave dhe masave pyjore si resurs për zhvillim ekonomik.

### **Trashëgimia Kulturore**

Për komunën e Kamenicës pikërisht trashëgimia kulturore është një ndër elementet më të rëndësishme që do të fuqizoj identitetin e kësaj komune dhe planifikimi i së kaluarës (trashëgimisë) është po aq i rëndësishëm sa planifikimi i së ardhmes. Andaj parashikohet që në përgjithësi kjo pasuri e trashëguar me vlera artistike, estetike, historike dhe kaakteristika tradicionale, që ilustron me llojllojshmërinë e pasur të trashëgimisë: arkitekturore, arkeologjike, të luajtshme, arkivore dhe shpirtërore pasi që e kemi bërë një përnjohje dhe e kemi të digjitalizuar si informatë në profil, kemi analizuar situatën në këtë fushë është konstatuar se duhet zhvillohen projekte që mundësojnë ti mbrojmë nga dëmtimet e mëtutjeshme por edhe ti zhvillojmë dhe bëjmë të mundur që këto vlera të fillojnë të shihen, preken dhe vlerësohen në dimensionin adekuat nga banorët e Kamenicës dhe vizitorët.

#### 4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Lokacioni për zgjerimin e vendshfrytëzimit të argjilës e cila gjendet në parcelat Zona Kadastrale, Topanicë-Kamenicë;

- P-71107074-03231-0, S=6849 m<sup>2</sup>
- P-71107074-03244-0, S=8826 m<sup>2</sup> dhe
- P-71107074-02381-0, S=946 m<sup>2</sup>

Në fshatin Topanicë, Komuna e Kamenicës. Lokacioni, sipas Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Kamenicës (2013-2023) ka destinim për kullosë, shiko faqe 488 harta nr.56, pra nuk do të ndërrohet destinimi i përdorimit të tokës. Sipërfaqja e saj në total është 16621m<sup>2</sup>, zgjerimi i vëndshfrytëzimit të argjilës që do të shfrytëzohet për prodhimin e bllokave nga argjila ne fabrikën e cila gjendet në fshatin Kërmjan i Poshtëm, K.Ranillugë.

Projekti i "Brickos" sh.p.k, do të përdoret vetëm për shfrytëzimin e argjilës për nëvoja të fabrikës për prodhimin e bllokave nga argjila, duke ofruar shërbime të mira dhe siguri sa i përket edhe qështjës mjedisore.

Projekti do të ofrojë shërbime sa më të mira dhe do të shtoj kujdës të vëqant në ruajtjen e mjedisit, ne veqanti toka dhe uji.

Më saktësisht në këtë projekt do të përfshihen këto objektë përcjellëse me sipërfaqe dhe koordinata, si ne vijim;



Figura 14. Lokacioni i Projektit të vëndshfrytëzimit të argjilës, lokacioni Topanicë, K.Kamenicë "Brickos" sh.p.k.



Figura 15. Parcela P-71107074-03231-0, S=6849 m<sup>2</sup> për vëndshfrytëzimin e argjilës, lokacioni Topanicë, K.Kamenicë "Brickos" sh.p.k.




Figura 16. Parcela P-71107074-03244-0, S=8826 m<sup>2</sup> për vëndshfrytëzimin e argjilës, lokacioni Topanicë, K.Kamenicë "Brickos" sh.p.k.



Figura 17. Parcela P-71107074-02381-0, S=946 m<sup>2</sup> për vëndshfrytëzimin e argjilës, lokacioni Topaninë, K.Kamenicë "Brickos" sh.p.k.

Dhe lokacioni për zgjërimin e vëndshfrytëzimit të argjilës e cila gjendet në parcelat Zona Kadastrale, Kërminjan i Poshtëm, Ranillug.

- P-73507033-00084-0, S=5019 m<sup>2</sup>
- P-73507033-02895-0, S=42215 m<sup>2</sup>
- P-73507033-00067-0, S=8374 m<sup>2</sup>



Figura 18. Lokacioni i Projektit të vëndshfrytëzimit të argjilës, lokacioni Kërminjan i Poshtëm, K.Ranillug "Brickos" sh.p.k.




Figura 19. Parcela P-73507033-02895-0, S=42215 m<sup>2</sup> për vëndshfrytëzimin e argjilës, lokacioni Kërminjan i Poshtëm, K.Ranillug “Brickos”sh.p.k.




Figura 20. Parcela P-73507033-00067-0, S=8374 m<sup>2</sup>, për vëndshfrytëzimin e argjilës, lokacioni Kërminjan i Poshtëm, K.Ranillug “Brickos”sh.p.k





Figura 21. Parcela P-73507033-00084-0, S=5019 m<sup>2</sup>, për vëndshfrytëzimin e argjilës, lokacioni Kërminjan i Poshtëm, K.Ranillug "Brickos"sh.p.k.

### Lokacioni

Lokacioni për zgjërimin e vendshfrytëzimit të argjilës e cila gjendet në parcelat kadastrale; P-71107074-03231-0, P-71107074-03244-0 dhe P-71107074-02381-0, në fshatin Topanicë, Komuna e Kamenicës me koordinatat 42°31'19"N, 20°37'04". Sipërfaqja e lokacionit ne total është 16621m<sup>2</sup>. Zona e Projektit ka lidhje të mirë infrastrukurore për bartjen e materialit nga argjila, ndërsa lokacioni për zgjërimin e vendshfrytëzimit të argjilës e cila gjendet në parcelat kadastrale; P-73507033-00084-0, P-73507033-02895-0, P-73507033-00067-0, në fshatin Kërminjan i Poshtëm, Komuna Ranillug me koordinatat 42°31'18"N, 21°37'07". Sipërfaqja e lokacionit ne total është 55608 m<sup>2</sup>. Zona e Projektit ka lidhje të mirë infrastrukurore për bartjen e materialit nga argjila.




Figura 22. Lokacioni i projektit të realizuar në fshati Topanicë, K.Kamenicë dhe pamja e fabrikës së bllokave ne fshatin Kërminjan i Poshtëm, K.Ranillugë.

### Procesi i punës-Gërmimi i materialit argjilor

Për ta bërë gërmimin (eksploatimin) e argjilës së pari duhet të bëhen disa shpime në thellësi prej 30m dhe për secilin shpim mirren kampionët dhe dërgohen në laborator në mënyrë që t'i bëhen analizat laboratorike. Pas kryerjes së analizave përpilohet elaborati gjeomekanik nga instituti i specializuar për këtë punë dhe nëse të gjitha analizat janë komfor normave të lejuara atëherë drejtohet kërkesa në KPMM (Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale) në mënyrë që të mirret leja për eksploatim. Pasi të mirret leja, fillon gërmimi i materialit dhe me makineritë përkatëse bëhet bartja deri në deponitë e fabrikës. Me qëllim që argjila të përpunohet sa më mirë, ajo duhet t'i nënshtrohet një trajtimi paraprak nëpërmjet veprimit të vazhdueshëm të agjentëve atmosferikë. Veprimi i alternuar i cikluseve të ngrirjes dhe shkrirjes dimërore në ajër të hapur shkatërron strukturën natyrore të argjilave, sjell shpërbërjen në grimca elementare të saj etj., gjë që çon në rritjen e plasticitetit e për pasojë dhe vetitë e formimit të masës së argjilës.

Depozitimi i lëndës së parë argjilore bëhet pranë fabrikës, me shtresa me trashësi 30-50 cm për një periudhë kohe 12 muajsh. Lartësia e përgjithshme e masës së formuar

me këto shtresa sillet (8-10)m, ndërsa gjatësia (60-80)m. Me qëllim që lënda e parë të jetë sa më përfaqësuese e vendburimit, rekomandohet që deponia të bëhet shtresa-shtresa, e cila pastaj kur merret për prodhimin të jetë sa më e përzier me të gjitha komponentët.

Makineria që shfrytëzohet për eksploatimin e argjilës është e njejtë sukur në vendshfrytëzimet që i është i kompletuar me dokumentacion të nevojshëm nga MMPHI, përbehët nga:

- **Bager,**
- **Eskavatorë,**
- **Kamionë për ngarkim për transport varësisht nga nevoja .**

Në vijim mund të shihet se si kryhet procesi i punës të një vëndshfrytëzimi aktual nga faza fillëstare me largimin e shtresës së humusit, deri tek deponimi në fabrikë për prodhimin e bllokave nga argjila. Transportimi i argjilës kryhet kryesisht me mjete transportuese duke arritur deri në destinimin e duhur tek fabrika "Brickos" sh.p. k e cila pas deponimit kalon nëpër dozator dhe me pas fillon procesi për prodhimin e bllokave përmes shiritave transportuës e deri tek produkti final.





*Foto 1-8. Shihet fillimi i largimit të shtresës së humusit dhe procesi i punës në tërësi deri tek deponimi dhe përpunimi i argjilës në fabrikë dhe përgatitja e procesit të punës për prodhimin e bllokave nga argjila.*

## 5. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Ky kapitull identifikon dhe vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore të projektit të propozuar të "Brickos" sh.p.k në mjedisin fizik, social dhe njerëzor brenda zonës së ndikimit të projektit të propozuar. Ndikimet e mundshme janë vlerësuar për të gjitha aktivitetet si qendër rekreacioni në këtë lokacion.

Ndikimet (presioni) në mjedis domosdos se vinë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin ideor të konceptuar e të diskutuar më lartë në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën - parcelën për zgjerimin e vëndshfrytëzimit të argjilës nga kompania "Brickos" sh.p.k. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

### **Ndikimet në cilësinë e ajrit**

Gjatë funksionimit të projektit do t'i kushtohet rëndësi e veçantë mbrojtjes së ajrit në këtë pjesë që mund të mbulojë një sipërfaqe të madhe të popullsisë vendase, florës dhe faunës, tokës dhe nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë në cilësinë e ujit duke pasë parasysh zhvillimin e këtij aktiviteti.

Duke u bazuar në lokacionin ku është duke u zhvilluar ky aktivitet, deri më tani mungojnë matjet mbi kualitetin e ajrit, por nuk priten të tejkalojnë vlerat kufitare të kualitetit të ajrit sipas të OBSH (ky lokalitet apo tërë ky regjion në aspektin e cilësisë së ajrit qëndron mjaft mire). Nuk priten përkeqësime lokale në cilësinë e ajrit në kuadër të lokalitetit të drejtpërdrejtë në fushën e kësaj veprimtarie. Një ndotje e ajrit për aktivitetin në fjalë nuk mund të pritën ndikime të theksuara dhe deri me tani nuk ka pasur ndonjë problem sa i përket cilësisë së ajrit dhe gjatë këtij aktiviteti do cdo herë do t'i kushtohet një rëndësi e veçantë në të gjitha aspektet mjedisore.

## Masat për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër te kompanisë “BRICKOS” Sh.p.k., transportin e argjilës për ne fabrikë ka marrë këto masa:

- Gjatë shfrytëzimit ka ndërmarrë të gjitha masat për rëvizimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, rëvizimin nga derdhja e vajrave të makinave, rëvizimin nga derdhja e karburanteve e posaçërisht gjatë furnizimit të makinave.
- Në kohra të nxehta bëhet spërkatja manipuluese dhe rrugës të pa asfaltuar kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithë ashtu kamionët gjatë transportit të argjilës mbulohen me mbulesë adekuate.
- Pas shfrytëzimit të argjilës kemi filluar me mbushjen e hapsirave të shfrytëzuara, në mënyrë që këto sipërfaqe, pas rikultivimit, të mos kenë ndryshime të dukshme, krahasuar me mjedisin që e rrethon.
- Është bërë thurja e ngastrës me gjembor.
- Pos kushteve të lartë cekur ne si kompani jemi duke ju përmbajur edhe kushteve të tjera të paraqitura ne raportin e VNM-së .

Kompania bënë kontrollin e rregullt teknik të makinerive transportuese lidhur me shfrytëzimin dhe bartjen e argjilës.

## Ndikimet në tokë

Nga shkarkimi i ujerave pas procesit të nxjerrjes së argjilës shtohet një kujdes i vecant për mos me ardhë deri tek ndotja e tokës në sipërfaqen e vendshfrytëzimit “Brickos” sh.p.k, për arsye se ka ndërmarr masa për kujdesin ndaj mjedisit dhe kushteve të parapara në dokumentacion. Ndërsa ndikime tjera si derdhje e vajrave etj, nuk ka. Ndikimi më i madh në cilësinë e tokës do të vije në rast të përdorimit të makinerive të vjetruara, për shkak të rrjedhjes së vajrave apo karburanteve. Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të ndryshme; si dhe nga mbetjet e ushqimit dhe paketimet që mund të rezultojnë nga stafi/punëtorët. Depozitimi i pluhurave të rezultuara si dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta që mund të përdoren në hapësirat e impiantit.

## Masat për mbrojtjen e tokës

Masat për parandalimin e ndotjes së tokës do të jenë pjesë e planeve të mëposhtme që do të zhvillohen nga Kontraktori: (i) Programi i Menaxhimit të Sigurt të Materialeve të Rrezikshme dhe Parandalimit të Derdhjeve, dhe (ii) Plani i Menaxhimit të Mbetjeve. Disa nga masat që mund të përmendim për mbrojtjen e tokës janë:

- Planifikimi paraprak i punës dhe realizimi i operacioneve në kohën më të shkurtër të mundshme. Kontroll dhe kolaudim periodik i gjendjes;
- Në rast të ndotjes aksidentale të tokës, duhet të hiqet dhe i ndotur dhe të ruhet në kontenierë të izoluar për t'u trajtuar më pas në vendin dhe mënyrën e përshtatshme;
- Të gjitha mbeturinat e krijuara duhet të mblidhen dhe të vendosen në kontejner me ato mbeturina të veprohet sipas rregullave të ligjit të mbeturinave Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina;
- Planifikimi i kujdesshëm dhe respektimi i ligjeve dhe rregulloreve mjedisore për sigurinë dhe ruajtjen e mjedisit gjatë punës.

### **Ndikimet në mjedisin ujq**

Ndikimi ne ujerat nëntokësor dhe ato mbitokësor mund te krahasohet me ndikimin ne toke pasi për ndikimet ne ujerat nëntokësorë dhe ato mbitokësore është e vlefshme i njëjti ndotës.

Derdhja e derivateve si nafta pastaj vajrat e ndikojnë në cilësinë e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Derivatet, vajrat dhe lubrifikantet të ndryshme të cilat mund të derdhen nga makineritë në përdorim. Pastrimi i ambientit në rast të ndonjë rrjedhjeje të padëshiruar, në rastet e pastrimit të automjeteve të transportit në zonën e impiantit.

### **Masat për mbrojtje nga zhurma**

“Brickos” sh.p.k, gjatë ushtrimit te aktivitetit te tij zhurma mund të shkatkohet vetëm gjatë përgatitjes se terrenit deri në përgatitje për transportim, duke qenë vend i përshtshëm për këtë aktivitet e cila do jetë brenda kufijve te lejuar. Parcela ku ushtron aktivitetin e tij kjo kompani është afër rrugës në fshatin Kamenicë. Masat e rekomanduara për te parandaluar, minimizuar dhe kontrolluar dëmtimet për shkak te zhurmës:

Megjithatë operatori duhet te marr te gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nen ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës ne kuadër te normave te lejuara, duke mirëmbajtë dhe kushtuar rendësi e veçante te gjitha pajisjeve te cilat emitojnë zhurme gjate procesit te punës.

### **Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë**

Në këto zona rriten llojet me të zakonshme të florës dhe faunës. Në këtë zone rriten dhe zhvillohen llojet e mbrojtura të florës dhe faunës. Zona përreth ku do të ushtrohet ky aktivitet nga “Brickos” sh.p.k, është zone jo shumë e banuar, andej do t'i kushtojmë një

rendësi të veçantë që të mos ketë ndonjë ndikim të madh. Gjithashtu, në këtë lokacion e as në zonën më gjerë deri më tani nuk është evidentuar ndonjë habitat i veçantë i llojeve të botës bimore apo shtazore.

### Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Kur është në pyetje procesi i VNM-së, ndër veçoritë kryesore janë edhe popullata, zhvillimet demografike si dhe vendbanimet. Kjo vjen në shprehje për shkak se afërsia e vendbanimeve dhe popullatës ndaj aktiviteteve janë, ndër faktorët kryesor të cilët i ekspozohen ndikimeve në mjedis. Kjo pozitë krijon të gjitha parakushtet për zhvillimin e kulturave bujqësore, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe të turizmit. E gjithë kjo ka ndikim në strukturën ekonomike të Kamenicës me rrethin.

“Brickos” sh.p.k në pikëpamje mjedisore nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në popullatë (zhvendosje), ndërkaq në anën tjetër pritet të ketë efekte pozitive në aspektin social-ekonomik respektivisht në punësimin e banorëve lokal dhe prodhim vëndor.

### Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë aktiviteteve të këtij aktiviteti mund të vlerësohen si raste të izoluar. Për të mos ardhur deri të ndonjë aksidenti eventual investitori “Brickos” sh.p.k, duhet që të merren të gjitha masat adekuate paraprakisht.

Tabela 5. Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponent i mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial të vogla për ndotjen e kualiteti të ajrit ambiental.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë erërave të forta të cilat mund të bartin pluhurin nga sipërfaqja e parcelës si dhe shtreget.	Mirëmbajtje e sipërfaqeve të parcelave.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin	Ndikimet mund të paraqiten si rezultat i keq menaxhimit jo të duhur të ujërave të	kompania në fjalë pasi kryen shkarkime të ujërave që shkarkohen duhet t'i kushtohet një rendësi



		ekziston te dheu dhe ujërat nëntokësore	shkarkuara toaletet dhe restoranti.	e veçantë ujore dhe mjedisore.
<b>Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)</b>		Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në zhdukje.	Sipërfaqja ku do të bëhet shfrytëzimi i argjilës nuk mund të ndikoj në shkallë mikrosistemi.	Me që në këtë lokacion mund të rriten dhe zhvillohen llojet e ndryshme të florës dhe faunës. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikimi është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
<b>Zhurma</b>		Potencial minimal	Nga ky aktivitet mund të ketë potenciale të vogla të shkaktimit të zhurmës.	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim të madh në ambientin jashtëm.
<b>Shëndeti i familjes dhe konsumatorëve</b>		Potencial relativ	Në kushte jo të duhura të plotsismi të kushtëve të	Te gjitha pajisjet të cilat mund të kenë ndikime në shëndetin e qytetareve do të kushtohet rëndësi e veçantë në mirëmbajtjen e tyre.

## 7. Menaxhimi i mbeturinave

Gjatë operimit të "Bricos" sh.p.k me lokacion në fshatin Topanicë, K.Kamenicë, mbeturinat të cilat krijohen si mbeturina sanitare është e kontraktuar me kompaninë e pastrimit. Prandaj këto mbeturina duhet të adresohen në mënyrë adekuate, në mënyrë që ato mos të jenë faktorë ndotje në mjedis dhe të jenë në harmoni me praktikën e mira mjedisore dhe ligjet vendore në fuqi. Për largimin e këtyre mbeturinave fabrika, ka marrëveshje me kompaninë për menaxhimin e mbeturinave nga komuna e Kamenicës, përkatësisht me kompaninë e lartë cekur.

Për mbetje e mundshme te këtij aktiviteti, zgjidhja është si ne vijim:

- Mbeturinat ditore nga personeli do të grumbullohen dhe do të adresohen në mënyrë adekuate në kontejnerët e ndërmarrjes komunale për mbeturina, ndërsa
- Ndërsa mbeturinat tjera eventuale nëse krijohen do te trajtohen konform legjislacionit adekuat për menaxhim me mbeturina.
- Po ashtu gjatë procesit të punës mbeturinat klasifikohen të cilat më pas merren nga kompanitë e kontraktuara.

## 6. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

### **Monitorimi**

Në bazë të gjendjes faktike në terren, pasi që ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore (nuk parasheh përdorim të ndonjë teknologjie e cila shkakton ndotje të madhe mjedisore as nuk parashihet monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor nuk është i domosdoshëm. Mirëpo është e rëndësisë se veçanta "Brickos" sh.p.k, se paku një herë ne vite te raportoj për gjendjen mjedisore pranë organit kompetent te MMPHI-së .

### **Raportimi**

Raportimi për gjendjen e përgjithshme mjedisore ne parcelën e saj si dhe hapësirës për rreth, do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin nëse do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht Lejen Mjedisore të lëshuara nga MMPHI.

## 7. KONKLUZIONE

Duke analizuar studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të konkludojmë si në vijim:

"Brickos" sh.p.k, e cila është e ndërtuar që nga vitet e hershme dhe që ushtron aktivitetin e saj në komunën Ranillugë ne Kerminjan të Poshtëm me fabrikë për podhimin e bllokave nga argjila, me person të autorizuar Ibush Rysha është në ndërsa me zgjerim të vëndshfryzimit me lokacion ne Topanicë, K.Kamenicë ;

- të vet investitorit për të përmirësuar kushte e punës, për të ngritur cilësinë e punës;
- në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe
- në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi punësimi, si dhe produkte me cilësi të sigurt.
- Në rast se kjo, mirëmbahet në mënyrë profesionale dhe me standarde siç parashihet të mirëmbahet dhe me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport, si dhe me bashkëpunimin e plotë me autoritetet. Ky vëndshfrytëzim i argjilës konsiderohet krejtësisht e pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik
- Duke u bazuar në natyrën e punës të saj dhe aktivitetit të tij, vendndodhjen, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë minimale, dhe tërësisht të kontrollueshme.

-Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit-aplikuesit "Brickos" sh.p.k me lokacion për vëndshfrytëzim të argjilës me lokacion ne fshatin Topanicë, K.Kamenicë.

## 8. REFERENCAT

1. Raport mbi gjendjen e Ujërave në Kosovë 2020 - AKMM
2. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Kamenicës 2013 - 2023+
3. Plan i Komunës së Kamenicës për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027
4. Kushtet Klimatike të Kosovës (<https://ëëë.kosovo-mining.org/kosova/kushtet-klimatike/>)
5. Gjeologjia e Kosovës (<https://kosovo-mining.org/resurset-minerale/gjeologjia/>)
6. Hidrologjia e Kosovës (<https://ëëë.kosovo-mining.org/kosova/hidrologjia/>)
7. Harta Hidrologjike e Kosovës  
([https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Hidrografia\\_e\\_Kosov%C3%ABs#/media/Skeda:Hydrology.jpg](https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Hidrografia_e_Kosov%C3%ABs#/media/Skeda:Hydrology.jpg))
8. Raporti i Menaxhimit të Mbeturinave Komunale në Kosovë - AMMK  
(<https://ammk-rks.net/mjedisi/19>)
9. Të dhënat historike të klimës dhe motit për Kamenicën
10. Kualiteti i Ajrit në Kosovë (<https://ihmk-rks.net/?page=1,18>)
11. Kualiteti i Ajrit në Komunën e Kamenicës dhe Ranillug
12. Biodiversiteti i Kosovës (<https://ammk-rks.net/mjedisi/15/bio>)



## VLERESIMI I KOSTOS TE PROJEKTIT

Nr.	Pershkrimi	Njesia €(Euro)	Kosto €(Euro)
1	Pregadidja e terenit,pastrimi	Komplet	5000,00
2	Bager 914 Liebher	Komplet	36000,00
3	Bullduzher Honomag-600	Komplet	36000,00
4	Rrethoja e Minieres	Komplet	50000
5			
	Kosto totale		82000,00€





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije-  
Ministry of Trade and Industry

Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Kosovska Agencija za Registracije Biznisa /  
Kosova Business Registration Agency

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT  
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI  
CERTIFICATE OF REGISTRATION

70447504

(Nr. i biznesit / Br. biznisa / Business No.)

"BRICKOS" SH.P.K.

Emri i biznesit / Naziv biznisa / Name of Business

Lloji i biznesit  
BusinessType  
Tip biznesa

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar  
Limited liability company  
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Adresa  
Address  
Adresa

Republika e Kosovës, Kamenicë, Kamenicë  
Republic of Kosovo, Kosovska Kamenica, Kosovska Kamenica  
Republika Kosova, Kosovska Kamenica, Kosovska Kamenica

Korminjan i Poshtëm

Data e inkomporimit  
Date of Incorporation  
Datum inkorporiranjë


06/11/2008

Data e regjistrimit  
Date of registration  
Datum registracije

04/09/2007

06/11/2008  
Data/Date/Datum

  
Nenshkrimi/Signature/Potpis





Informata mbi biznesin  
Information about business  
Informacija o biznisu

Nr. Biznesit/Business No./Br. Biznisa  
70447504

Aplikacioni/Application/Aplikacija

Subjekt i regjistrimit:  
Registration subject  
Subjekt registracije:

Data e plotësimit:

Filling date: 04/09/2007  
Datum:

Date e pranimit:

Reception date:  
Datum primljenje

Numri i protokolit:

Protocol number: 119237235  
Broj protokola:

Biznesi/Business/Biznis

Tipi i biznesit:  
Business type: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara  
Limited liability company  
Tipi biznesa: Društvo sa ogranicenom odgovornošću

Emri i biznesit:  
Business name: "BRICKOS " SH.P.K.  
Naziv biznesa:

Adresa:  
Address: Republika e Kosovës, Kamenicë, Kamenicë  
Republic of Kosovo, Kosovska Kamenica, Kosovska Kamenica  
Adresa: Republika Kosova, Kosovska Kamenica, Kosovska Kamenica  
Korminjan i Poshtëm

Data e konstituimit:  
Constitution date: 06/11/2008  
Datum konstituisanja:

Kapitali i përgjithshëm:  
Total Capital: €1,792,165.38  
Totalni kapital:

Numri i puntorëve:  
Number of employees: 81  
Broj radnika:





70447504

**Pronarët/Owners/Vlasnici**

Person fizik

**Emri:**  
**Name:** Mustafë  
**Ime:** Borovci

**ID Personale:**  
**Personal ID:** 1000840854  
**Licni ID:**

**Adresa:** Republika e Kosovës,Kamenicë,Kamenicë  
**Address:** Republic of Kosovo,Kosovska Kamenica,Kosovska Kamenica  
**Adresa:** Republika Kosova,Kosovska Kamenica,Kosovska Kamenica  
Besnik Marovca

**Përgjegjësia:**  
**Liability:**  
**Odgovornost:** Përgjegjësi e kufizuar

**Pjesa në pronë:**  
**Owned part:** €896,082.91  
**Deo o vlasnistvu:**

**Pjesa e paguar:**  
**Paid Part:** €896,082.91  
**Placeni deo:**

Person fizik

**Emri:**  
**Name:** Kamer  
**Ime:** Borovci

**ID Personale:**  
**Personal ID:** 1000840854  
**Licni ID:**

**Adresa:** Republika e Kosovës,Kamenicë,Kamenicë  
**Address:** Republic of Kosovo,Kosovska Kamenica,Kosovska Kamenica  
**Adresa:** Republika Kosova,Kosovska Kamenica,Kosovska Kamenica  
Besnik Marovci

**Përgjegjësia:**  
**Liability:**  
**Odgovornost:** Përgjegjësi e kufizuar

**Pjesa në pronë:**  
**Owned part:** €896,082.91  
**Deo o vlasnistvu:**

**Pjesa e paguar:**  
**Paid Part:** €896,082.91  
**Placeni deo:**



70447504

**Venimtaritë/Activities/Delatnosti**

<b>2640</b>	Primar	Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve për ndërtim me baltë të pjekur
	Primary	Manufacture of bricks, tiles and construction products, in baked clay
